

KËTË JAVË:

- **14 janari: Konkluzionet e vëzhguesve të të drejtave të njeriut**
- **Konferencë shtypi për protestën paqësore më 22 janar**

Nr.286, 20 janar 2012

14 janari: Konkluzionet e vëzhguesve të të drejtave të njeriut

Në komunikatën e Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili kishte dërguar ekupe me vëzhgues në të dy pikat kufitare, thuhet se, "Intervenimi i policisë, përzgjedhja e mjeteve dhe e metodave si dhe përdorimi i dhunës gjatë protestës në Podujevë dhe te Dheu i Bardhë, nga Avokati i Popullit konsiderohet si i panevojshëm, i pajustificueshëm dhe joproportional." Gjithashtu, në komunikatë thuhet: "Përgjithësisht, në fillim arrestimet janë bërë në mënyrë përzgjedhëse, me fokus të veçantë tek organizatorët, sidomos deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të pranishëm në protestë, ndaj të cilëve është përdorur dhunë, e përcjellë me veprime degraduese dhe poshtëruese. Po ashtu gjatë ndërhyrjes së policisë dhunë është përdorur edhe ndaj një përfaqësuesi të mediave në krye të detyrës."

Në protestë kishte edhe monitorues nga KMDLNJ-ja, e cila në deklaratën e vet thotë se "intervenimi i policisë ka qenë i ngutshëm dhe i panevojshëm, sepse askush nuk ka qenë i rrezikuar gjatë kohëzgjatjes së protestës." Gjithashtu, në deklaratën e tyre thuhet: "Duket se ka munguar vullneti për zgjidhje të problemit pa përdorim të forcës dhe janë ngritur tensionet pa pasur nevojë në raste të caktuara policia ka tejkaluar autorizimet duke përdorur forcë ndaj të arrestuarve"

Në komunikatën e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, e cila kishte dërguar vëzhguesit e saj në protestë, thuhet: "QKRMT shpreh shqetësim e saj për përdorimin e forcës ndaj protestuesve." Sipas QKRMT-së: "Intervenimi i Policisë së Kosovës ka qenë i pa provokuar nga masa e protestuesve, protestuesit kanë qenë të qetë dhe organizatorët vazhdimisht kanë apeluar për protestë paqësore, duke u mundur që të mbajnë rend dhe qetësi në mesin e protestuesve."

Organizata Amnesty International nxori një deklaratë, nëpërmjet së cilës ajo, "e dënon përdorimin e tepruar të forcës nga Policia e Kosovës kundër protestuesve paqësorë në dy demonstratat e mbajtura të shtunën më 14 janar." Am-

nesty u bëri me dije institucioneve të ligjit dhe rendit në Kosovë se, "standardet ndërkombëtare për ruajtjen e rendit nga policia kërkojnë që përdorimi i forcës të jetë proporcional dhe në përputhje me ligjin shtetëror dhe me ligjet dhe standardet për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, duke përfshirë Kodin e OKB-së për Sjelljen e Zyrtarëve për Zbatimin të Rendit dhe Parimet Themelore të OKB për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët për Zbatimin e Rendit, në të cilin thuhet: "Në shpërndarjen e turmave që janë të paligjshme, por të padhunshme, zyrtarët për zbatimin e rendit duhet t'i shmangen përdorimit të forcës ose, kur kjo nuk është e mundur, duhet ta kufizojnë përdorimin e forcës së tillë në masën minimale".

Në mbrojtje të Republikës, Për prodhime të vendit SERBIA NUK KALON!

Konferencë shtypi për protestën paqësore më 22 janar

Në një konferencë për media të mbajtur të shtunën më 21 janar Albin Kurti dhe Glauk Konjufca sqaruan pozicionin e Lëvizjes VETËVENDOSJE! për shfuqizimin e vendimit të parlamentit për reciprocitet me Serbinë nga Qeveria të premten më 20 janar.

Albin Kurti tha se duke e sulmuar protestën paqësore më 14 janar qeveria ia ka hapur rrugën Serbisë ekonomikisht, kurse duke e anuluar vendimin e parlamentit dje, ajo ia ka hapur rrugën Serbisë edhe politikisht. Ai tha:

"Qeveria vazhdimisht po bën krahasime mes demonstratës sonë dhe veriut. Ky krahasim nuk po ndodh ashtu që Qeveria të veprojë kundër strukturave kriminale të Serbisë. Ky krahasim po ndodh pikërisht që ne të goditemi në emër të strukturave kriminale, e ato të vazhdojnë të mbesin. Thaçi nuk e ka me strukturat e Beogradit. Ai e ka me qytetarët dhe popullin paqësor të Kosovës. Strukturat kriminale të Serbisë, Thaçi ka thënë se i ka partnerë të dialogut, kurse praktikisht i ka edhe bashkëpunëtorë të kriminit ekonomik. Nuk është çështja vetëm e reciprocitetit këto ditë por e anashkalimeve të planifikuara të Kuvendit nga ana e Qeverisë në këtë vitin 2012 në të cilin hymë tash. Qeveria mendon ta shesë Dis-

tribucionin e KEK-ut, PTK-në dhe Trepçën dhe me dialogun politik ta pranojnë autonominë për veriun, dhe për këtë qëllim dëshironi ta eliminoni Kuvendin e Kosovës si pengesë. Me mënyrat e kësaj Qeverie po dështon shteti i Kosovës, po dështon si republikë dhe si ekonomi. Ne jemi subjekti që kemi kërkuar dorëheqjen e Qeverisë dhe zgjedhjet e parakohshme, mirëpo, me protestën tonë të nesërme, synojmë që t'ia marrë pushtetin Serbisë në Kosovë dhe t'ia japë këtë pushtet, shtetit të Kosovës që duam ta forcojmë. Kërkojmë nga Policia e Kosovës, e posaçërisht nga njësitë speciale të saj, që të mos na pengojnë në pengimin e Serbisë. Ne po na zhdukët Republika përdërisa s'kemi reciprocitet me Serbinë. Protesta paqësore e demokratizimit Republikën."

"Përdërisa më 14 janar po e mbronim një vendim të Kuvendit, më 22 janar po e mbrojmë republikanizmin."- Glauk Konjufca

Glauk Konjufca tha se me aktin e Qeverisë më 20 janar ka vdekur republikanizmi dhe parlamentarizmi në Kosovë. Ai tha:

"Tash po e kuptojmë se çdo të thotë kjo shprehja Kosova është shtet sui generis. Ne jemi sui generis ndaj Serbisë. Me ditën e djeshme Kosova si shtet ka hyrë në një fazë të re të autoritarizmit të pushtetit. Tash të gjithë po e kuptojmë se kemi një Qeveri tërësisht të pakufizuar nga Kuvendi. Dje Qeveria na ka thënë: unë bëj ç'të dua me shtetin sepse i kam 59 deputetë."

Miratimi i marrëveshjeve me Serbinë me 59 deputetë, tregon se Qeveria e konsideron Kosovën pjesë të Serbisë. Kushtetuta thotë se marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Kjo do të thotë minimum 80 vota nga 120 ulëse të Kuvendit. Çfarë ironie: në po të njëjtën seancë miratohet një marrëveshje me gjermanët me 81 vota dhe menjëherë pastaj marrëveshjet me Serbinë me 59 vota. Hashim Thaçi dje na ka treguar se meqë i ka 59 deputetë mund ta sjellë Serbinë brenda Kosovës. Kjo është diktatura e numrave."



Duajë tënden.